

Funksioni 04: ÇËSHTJE EKONOMIKE

PROGRAMI 04130: MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Përmbajtja

HYRJE	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 04130	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT	5
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	8
4. TË DHËNA MBI PROGRAMIN	13
5. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2022-2024	14

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04130

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik	<ul style="list-style-type: none">Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve;Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj. <p>Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin;</p>

Rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kuadër, politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër janë fokusuar në zhvillimin e një ekonomie të gjallë për qytetin dhe zonat rurale sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

Tabela 1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2022-2024								
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Shkodër	Institucioni-							
Programi	4130	Mbështetja për zhvillimin ekonomik						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	987	1,238	1,269	1,416	1,337	1,363	1,391
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	165	207	212	237	212	217	221
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	792	94	3,321	2,413	2,729	2,729	2,729
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	3,584	3,575	5,631	4,686	3,940	3,940	3,940
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI		5,528	5,114	10,433	8,752	8,218	8,249	8,281

Komente

Programi 04130: Mbeshtetje per zhillimin ekonomik, ka si burim financimi transfertën e kushtëzuar, transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat. Ne vitet 2022, 2023 dhe 2024 fondet e deleguara përdoren për funksionin e mbështetjes për zhvillim ekonomik për mbulimin e shpenzimeve për QKR.

Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulojnë nga të ardhurat e bashkise dhe transfertat e pakushtëzuar për funksionin e mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe zënë mesatarisht 77.9 %.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korrente me rreth:

- 81.2 % në vitin 2022 ,
- 80.8 % në vitin 2023 dhe
- 80.5 % në vitin 2024.

Ndërsa pagat dhe sigurimet shoqërore zënë:

- 18.8 % në vitin 2022,
- 19.2 % në vitin 2023 dhe
- 19.5 % në vitin 2024.

Shpenzimet kapitale zënë 0% të shpenzimeve totale për vitet 2022, 2023, 2024.

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT			
Programi Buxhetor Afatmesëm		2022-2024	
Programi	0413 0	Mbështetja për zhvillim ekonomik	
Përshkrimi i Programit			
<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe licensimit të bizneseve; • Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; • Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; • Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ; • Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj. • Publikimi i broshurave informative, krijimi portaleve me profil ekonomik etj. • Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin; 			
1	Qëllimi i Politikës së Programit	Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Europian. Mbështetjen e veprimtarive prodhuese nëpërmjet promovimit të tyre dhe asistimit për përthithjen e granteve dhe ndihmave financiare.	
		2021	2022
		2023	2024

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi		Buxheti	Plani	Plani	Plani
Qëndrueshmëria dhe rritja e bizneseve aktive në territor		5809	5900	6000	6100
Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian si dhe Organizata të tjera ndërkombëtare		16	20	22	22
1.1	Objektivi i Politikës së Programit	Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Ulët		57%	52%	47%	42%
Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mesme		33%	35%	38%	40%
Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mirë		10%	13%	15%	18%
OSHE-ve pjesëmarrëse në proces/ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës		22%	9%	8%	0%
Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare-ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar		25%	10%	0%	0%
Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar		-50%	0%	0%	0%
Numri i aktiviteteve me karakter informues		-5%	13%	0%	0%

	-Ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar				
	Numri i përfituesve nga aktivitetet informuese, ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	10%	9%	0%	0%
1.2	Objektivi i Politikës së Programit	Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Numri i panairove të organizuara në Bashkinë Shkodër për promovimin e biznesit vendor , ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	43%	0%	0%	0%
	Numri i shërbimeve të ofruara ndaj biznesit (hapje , mbyllje, ndryshime, pezullimi nipt-i etj), ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	0%	0%	0%	0%
1.3	Objektivi i Politikës së Programit	Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Promovim më i mirë i zhvillimit ekonomik nepermjet materialeve te botuara:ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	0%	0%	0%	0%
1.4	Objektivi i Politikës së Programit	Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet iniciativave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Bizneseve të mbështetura në skemë financiare: -Raporti në % i kundrejt vitit të kaluar	5%	0%	0%	0%
	Bizneseve të asistuar për aplikime në skemë financiare -Raporti në % i kundrejt vitit të kaluar	-17%	0%	0%	0%
Kryetari i Bashkisë		Koordinatori i GMS		Drejtori i programit	

Emri Mbiemri:	Voltana Ademi	Emri Mbiemri:	Voltana Ademi	Emri Mbiemri	Ridvan Sokoli
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	05.01.2022	Datë:	05.01.2022	Datë:	05.01.2022

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm			2022-2024		
Programi		04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik		
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Mbështetja për përmiresimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale.			
1.1.A	Produkti	Dokumenti monitorimit të strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P04130.O1.A1			
	Përshkrimi i Produktit:	Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	198	198	198	198
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
1.1.B	Produkti	OSHC me kapacitete të forcuara			

	Kodi i Projektit	P04130.O1.A2			
	Përshkrimi i Produktit:	Vazhdimi i zbatimit të metodologjise ReLoad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	11	12	13	13
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		9.1%	8.3%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale				
	Ndryshimi në % i kostos për njësi				
1.1.C	Produkti	Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare			
	Kodi i Projektit	P04130.O1.A3			
	Përshkrimi i Produktit:	Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtaresimi në shoqata ndërkombëtare.			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	3	3	3	3
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	1,000	1,000	1,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	333.3	333.3	333.3	333.3
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		0.0%	0.0%	0.0%
1.1.D	Produkti	Aktivitete informuese			
	Kodi i Projektit	P04130.O1.A4			
	Përshkrimi i Produktit:	Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër,			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	40	45	45	45

	Kosto totale (në mijë lekë)	43	43	43	43
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	1.1	1.0	1.0	1.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		12.5%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-11.1%	0.0%	0.0%
1.1.E	Produkti	Persona të informuar			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P04130.O1.A5			
	Përshkrimi i Produktit:	Informimi në mënyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritimit Evropian, Këndi BE Shkodër,			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	220	240	240	240
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		9.1%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale				
	Ndryshimi në % i kostos për njësi				
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.			
1.2.A	Produkti	Panaire të produkteve dhe shërbimeve të territorit			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P04130.O2.A1-P04130.O2.A3			
	Përshkrimi i Produktit:	Organizim i panaireve në qytet dhe NJ.A e bashkisë Shkodër me qëllim promovimin e produkteve dhe shërbimeve vendore			
	Njësia Matëse	numër panairesh			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	10	10	10	10
	Kosto totale (në mijë lekë)	2,440	2,440	2,440	2,440
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	244.0	244.0	244.0	244.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%

	Ndryshimi në % i kostos për njësi		0.0%	0.0%	0.0%
1.2.B	Produkti	Numri i shërbimeve të ofruara ndaj biznesit (hapje, mbyllje, ndryshime, pezullimi nipt-i etj)			
	Kodi i Projektit	P04130.O2.A4			
	Përshkrimi i Produktit:	Shërbimet e deleguara të QKB			
	Njësia Matëse	numër			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	4	4	4	4
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,567	1,635	1,666	1,698
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	391.8	408.8	416.5	424.5
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		4.3%	1.9%	1.9%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		4.3%	1.9%	1.9%
1.3.	Objektivi i Politikës së Programit	Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.			
1.3.A	Produkti	Publikime dhe botime			
	Kodi i Projektit	P04130.O3.A1-P04130.O3.A2			
	Përshkrimi i Produktit:	Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).			
	Njësia Matëse	numër publikime dhe botime			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	1	1	1	1
	Kosto totale (në mijë lekë)	200	200	200	200
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	200.0	200.0	200.0	200.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		0.0%	0.0%	0.0%
1.4.	Objektivi i Politikës së Programit	Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet iniciativave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.			
1.4.A	Produkti	Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht			
	Kodi i Projektit	P04130.O4.A1-P04130.O4.A2			

Përshkrimi i Produktit:		Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori si dhe Mbeshtetja e iniciativave të reja			
Njësia Matëse		numër biznesesh			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
Sasia		200	200	200	200
Kosto totale (në mijë lekë)		2,600	2,900	2,900	2,900
Kosto për njësi (në mijë lekë)		13.0	14.5	14.5	14.5
Ndryshimi në % i Sasisë			0.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos totale			11.5%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi			11.5%	0.0%	0.0%
1.4.B	Produkti	Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare			
<i>Kodi i Projektit</i>		P04130.O4.A3			
Përshkrimi i Produktit:		Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.			
Njësia Matëse		numër biznesesh			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
Sasia		25	25	25	25
Kosto totale (në mijë lekë)		0	0	0	0
Kosto për njësi (në mijë lekë)		0.0	0.0	0.0	0.0
Ndryshimi në % i Sasisë			0.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos totale			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
Ndryshimi në % i kostos për njësi			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
Kryetari i Bashkisë		Koordinatori i GMS		Drejtori i programit	
Emri Mbiemri:	Voltana Ademi	Emri Mbiemri:	Voltana Ademi	Emri Mbiemri:	Ridvan Sokoli
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	05.01.2022	Datë:	05.01.2022	Datë:	05.01.2022

4. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 4 Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin						
	Të Përgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
Të dhënat e programit/ Vitet						
Numri i projekteve gjithsej te Dokumenti i Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër		198	198	198	198	198
Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të ulët zbatimi		123	113	103	93	83
Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të mesëm zbatimi		60	65	70	75	80
Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të mirë zbatimi		15	20	25	30	35
Numri i OSHC-ve pjesëmarrëse në proces		9	11	12	13	13
Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare		6	3	3	3	3
Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare		16	20	22	22	22
Numri i aktiviteteve informuese të organizuara		42	40	45	45	45
Numri i personave të informuar		200	220	240	240	240
Numri i panaireve me produkte dhe shërbime vendore		7	10	10	10	10
Numri i shërbimeve (hapje, mbyllje, ndryshime, pezullimi nipt-i etj)		4	4	4	4	4
Numri i materialeve informative të publikuara/botuara për zhvillimin ekonomik.		1	1	1	1	1

Numri i bizneseve të mbështetura për zhvillim		190	200	200	200	200
Numri i bizneseve të asistuar në aplikime në programe dhe skema financiare		30	25	25	25	25

5. Projektet e planifikuara për PBA 2022-2024

Tabela 5 Emërtimet e aktiviteteve

Projekte të planifikuara			000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Buxheti 2024
P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër	0	0	0
P04130.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjise ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.	0	0	0
P04130.O1.A3. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European, Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare.	1,000	1,000	1,000
P04130.O1.A4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit European nëpërmjet Këndit të BE Shkodër,	43	43	43
P04130.O1.A5. Informimi në mënyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritimit Evropian, Këndi BE Shkodër,	0	0	0
P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	300	300	300
P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative	700	700	700
P04130.O2.A3. Panairi i promovimit të vlerave artistiko- kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	1,440	1,440	1,440
P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB	1,635	1,666	1,698
P04130.O3.A1. Botimi i profilit të bizneseve të Bashkisë Shkodër në anglisht	0	0	0
P04130.O3.A2. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).	200	200	200

P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori	1,600	1,600	1,600
P04130.O4.A2. Mbështetja e iniciativave të reja të zonave tregtare	1,300	1,300	1,300
P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	0	0	0
Totali	8,218	8,249	8,281

Nr. 1	P04130.O1.A1 Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Plani i Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë. Ky aktivitet realizohet me stafin e angazhuar në administratën e Bashkisë Shkodër, të trajnuar dhe të specializuar.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Projekti ka për qëllim të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i planit për analizën e të dhënave; Analizimi i të dhënave për ndikimin e planit, zbatimin i aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve të tij; Gjetja e rekomandimeve dhe konkluzioneve; Përgatitja e raportit të monitorimit dhe vlerësimit; Shpërndarja e informacionit. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> Realizimi i monitorimit për çdo vit në fund të një viti fiskal i Planit të Përgjithshëm Vendor për situatën aktuale dhe zbatimin e PPV-së për identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjes dhe matjen e progresit ndaj rezultateve të dhëna. Realizimi i vlerësimit të kryer në mes dhe në fund të periudhës së zbatimit të i Planit të Përgjithshëm Vendor. 		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
Bashkia Shkodër Grupet e interesit		Bashkia Shkodër, Donatorë, Programe të BE-së.
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)
		Nga kjo:
		Paga
		Sigurime
		Operative
		Transferime
		Kapitale
A.1	Monitorimi dhe vlerësimi i Planit	

	Shuma						
f)) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër						

Nr. 2	P04130.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër ka përbushur me sukses detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga angazhimi i saj në Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOad). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Evropian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOad, Bashkia Shkodër mori përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projektit ReLOad dhe angazhimin e organizimit të tre thirrje publike (periudhën kohore 2018 – 2020), nga të cilat, dy të parat u financuan nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit u financua nga fondet e vetë bashkisë. Të gjitha Thirrjet për projekt propozime u realizohen në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”. Aktualisht Bashkia Shkodër ka nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me UNDP Albania në kuadër të RELOAD 2, e cila do të përfundojë në dhjetor të vitit 2024. Ky memorandum prevalon dhe zëvendëson në tërësinë e tij memorandumun e bashkëpunimit të nënshkruar nga Bashkia Shkodër në vitin 2017 dhe ka për qëllim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkëmbimin e eksperiencave midis bashkive partnere të ReLOad nëpërmjet bashkëpunimit me programin në Shqipëri dhe Bashkinë Shkodër (si mentor). 2. Shkëmbimin direkt të njohurive midis qeverisjes vendore pjesëmarrëse, OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë në nivel rajonal. <p>Prandaj Bashkia Shkodër, duke e konsideruar praktikën e metodologjisë LOD si një praktikë e mirë unifikuese, mbështetur në standartet e Bashkimit Evropian për menaxhimin e projekteve, angazhohet që thirrjet për projektet propozime të fushës kulturore, artistike, sportive dhe rinore të vazhdojë ti realizojë sipas Metodologjisë LOD, miratuar me VKB nr. 69, datë 30.10.2017. Deri tani janë realizuar 4 thirrje të hapura për projekt propozime drejtuar organizatave të shoqërisë civile. Për vitin 2021 është parashikuar shpallja e thirrjes së hapur për projekt propozime drejtuar organizatave të shoqërisë civile sipas programeve buxhetore, si më poshtë:</p> <p>1.P04130 Mbështetja për zhvillim ekonomik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - P04130.O2.A2 Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative - P04130.O2.A3 Panairi i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative) <p>2. P04760 Zhvillimi i turizmit</p> <ul style="list-style-type: none"> - P04760.O2.A1 Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit - P04760.O3.A1 Festa e Liqenit - P04760.O3.A3 Hapja e sezonit turistik Velipoje - P04760.O3.A4 Festa e Thethit - P04760.O3.A5 Dita e biçikletave - P04760.O3.A6 Triathlon - P04760.O3.A8 Lojra Popullore Fest <p>3. P08220 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> - P08220.O3.A15 Festival Jazz-i - P08220.O3.A18 Shkodra n'fest - P08220.O3.A20 “Festa eTrashëgimisë Kulturore” <p>Fondi për secilin projekt ndodhet në programet buxhetore respektive. (P04130 Mbështetja për zhvillim ekonomik, P04760 Zhvillimi i turizmit, P08220 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore).</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi është zbatimi i qasjes në bazë projekti, në mënyrë që bashkitë të realizojnë objektivat e tyre zhvillimore, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër angazhohet të organizojë thirrjet publike për organizatat e shoqërisë civile në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (Reload), sipas metodologjisë LOD miratuar me VKB nr. 69, datë 30.10.2017; • Përcaktimi i prioriteteve, • Lancimi i thirrjes, 		

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i projekteve, • Zbatimi dhe Monitorimi i projekteve fituese. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> • Ngritje e kapaciteteve institucionale; • Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane; • Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje; • Rritje e transparencës me publikun. 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër UNDP Albania Delegacioni i Bashkimit European				Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) Bashkia Shkodër Programet e BE-së			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operat ive	Transfer ime	Kapita le
A.1	Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.						
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë vitit 2022, 2023,2024		Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtoria e Turizmit Drejtoria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Arsimit					
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 3	P04130.O1.A3. Pjesëmarrje në programet dhe projektet të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Procesi i integritimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Një element i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit është zhvillimi i bashkëpunimit rajonal. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal. Një gjë e tillë do të konsolidojë bazat e një shoqërie të hapur në rajon e cila mbështet ndarjen e përgjegjësi, resurseve dhe përparësive që rajoni ka, si dhe do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët me standarde evropiane.</p> <p>Në këtë kuadër Bashkia Shkodër do të intensifikojë përpjekjet e saj në drejtim të anëtarësimit në shoqata ndërkombëtare me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe mbrojtjen e mjedisit në bashkëpunim me vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm. Natyrisht anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare sjell të drejta dhe detyrime për vendet anëtarë, brenda kufijve të përcaktuara në statut. Një ndër këto detyrime është edhe shlyerja e kuotës vjetore të anëtarësisë. Prandaj për çdo anëtarësim të mundshëm në shoqata ndërkombëtare, Bashkia Shkodër merr përsipër përmbushjen e detyrimeve financiare (shlyerjen e kuotës vjetore të anëtarësisë) për kohën gjatë së cilës është pjesë e shoqatës.</p> <p>Gjithashtu duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së. Gjatë viteve të fundit numri i projekteve të financuara në kuadër të thirrjeve të IPA dhe programe të tjera të financuara nga BE është i konsiderueshëm. Përmendim këtu Programi Adrion Interreg, Horizon 2020, Europe Aid Call for Proposal, IPA Crossborder Shqipëri – Mali i Zi, etj. të konkretizuara në projektet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti Yes Future – Programi IADSA - Projekti Begin - Programi Adriatic-Ionian INTERREG V-B Transnational 2014-2020. Thirrja e I-rë për projekt propozime. - Projekti PARK4SUMP - Programi Horizon 2020 - Programi ReLOad – 3 Thirrje të hapura për aplikim dedikuar OSHC-ve. - Projekti RE LAKE "Rigjenerimi i zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodrës - Rajoni Friuli Venezia Giulia - Projekti 100 drita për të gjithë - Regional Development Programme Albania RDPA - Projekti DEAR - Programi IADSA - Projekti FARO - Programi Europe for Citizens - Projekti "Komuniteti i të ardhmes: Ndërrhyrje të përfshira sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodres" AID 10950 - Agjensia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS). - Projekti "Fuqizimi ekonomik dhe egjiptian për romt dhe egjiptianët - një shtysë për përfshirje sociale"- ESERE - Projekti Rikualifikimi dhe venia ne funksin e Muzeut ne Kalane e Drishtit - Programi ReLOad 2 <p>Në të dyja rastet lind e nevojshme parashikimi i një fondi për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe bashkëfinancimin në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të parashikojë fondin për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe të parashikojë fondin për bashkëfinancimet në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Evropian për periudhën 2022 – 2024. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër do të përmbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare. • Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë me mjete financiare projektet në të cilat është shpallur fituese nga BE, sipas marrëveshjeve financiare të nënshkuara nga Bashkia Shkodër në përputhje me legjislacionin në fuqi. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Ngritje e kapaciteteve institucionale; • Përmirësim i shërbimeve me standarde evropiane; • Përfshirje e Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare; • Rritje e transparencës me publikun. 						
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Evropian		Bashkia Shkodër Programet e BE-së Shoqata ndërkombëtare.				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022	Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.	200				200	

A.2	Vlerë e bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të BE-së:	800			800		
Shuma		1,000			800	200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.	200				200	
A.2	Vlerë e bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të BE-së:	800			800		
Shuma		1,000			800	200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare.	200				200	
A.2	Vlerë e bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të BE-së:	800			800		
Shuma		1,000			800	200	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 4	P04130.O1.A4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian nëpërmjet Këndit të BE-së Shkodër.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore", janë krijuar strukturat e Integritimit Evropian në 61 Bashkitë e Shqipërisë. Në këtë kuadër është krijuar struktura edhe në Bashkinë Shkodër, misioni i sëcilës është të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.</p> <p>Sa më sipër ky sektor do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor duke organizuar aktivitete të ndryshme informuese dhe promovuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim çdo muaj sektori i integritimit evropian Shkodër organizon minimalisht 2 aktivitete në muaj sipas tematikave të caktuara dhe sipas ditëve evropiane dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale, Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi, etj. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete varion nga 20 pjesëmarrës, në rastin e takimeve me fokus grupet deri në 400 pjesëmarrës në rastin e aktiviteteve të mëdha promovuese.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të promovojë parimet e Bashkimit Evropian në nivel vendor; • Të krijojë një ndërveprimi efektiv midis BE-së, qeverisjes qendrore dhe zyrës së çështjeve të BE -së në secilën Bashki në Shqipëri. • Të rrisë njohuritë për IPA-n si dhe fondet e tjera kryesore të BE-së të disponueshme për bashkitë dhe qytetarët Shqiptarë. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër do të organizojë aktivitete promovuese dhe informuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Funksionimi efektiv i zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër. • Ngritje e kapaciteteve institucionale; • Përmirësim i shërbimeve me standarde evropiane; • Rritje e transparencës me publikun. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Evropian				Bashkia Shkodër Programet e BE-së		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operati ve	Transfer ime
A.1	Materiale promocionale	43			43	
Shuma		43			43	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operati ve	Transfer ime
A.1	Materiale promocionale	43			43	
Shuma		43			43	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operati ve	Transfer ime
A.1	Materiale promocionale	43			43	
Shuma		43			43	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				
Gjatë vitit 2022, 2023,2024		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr. 5	P04130.O1.A5. Informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritimit evropian nëpërmjet zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Struktura e Integritimit Evropian Shkodër, si pjesë e rrjetit të 61 njësiteve të integritimit evropian në të gjithë Shqipërinë, i mbështetur nga projekti Bashkitë për Evropën, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesi të integritimit. Ky sektor do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor si dhe do të shërbejë si një urë për absorbimin e fondeve/programeve të BE. Informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integritimit evropian, për politikën e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian, nëpërmjet zyrave të Bashkimit Evropian, të cilat krijohen dhe funksionojnë brenda bashkisë. Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Shkodër do të sigurojë dhënien e informacionit të nevojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritimit evropian, për politikën e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian. Njëkohësisht do të bëjë shpërndarjen e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE-së.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Të rrisë njohuritë mbi politikën, objektivat, prioritetet, institucionet, programet dhe perspektivën e Bashkimit Evropian, si dhe të sqarojë mitet apo konceptet e gabuara në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër do të sigurojë informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritimit evropian. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Funksionimi efektiv i zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër. Ngritje e kapaciteteve institucionale; Përmirësim i shërbimeve me standarde evropiane. Rritje e transparencës me publikun. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Evropian				Bashkia Shkodër Programet e BE-së		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operative	Transferime kapitale
A.1	Informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritimit evropian					
Shuma						
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Gjatë vitit 2022, 2023,2024			Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit			
			Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër			

Nr.6	P04130.O2.A1 Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohet një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktiviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm, të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet vakante të punës, por gjithashtu edhe për nevojën që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër, ashtu si vitin e kaluar, ka parashikuar organizimin e panairit të përvitshëm të punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Universitetin e Shkodrës, Zyren Rajonale të Punësimit, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitetin e tyre tregtar në Shkodër dhe më gjërë. Në këtë panair, bizneset do të kenë mundësi të promovojnë produktet e tyre, si një mundësi për tu njohur në tregun rajonal e më gjërë si dhe te njihen me potencialin e fuqisë punëtorë të kualifikuar.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Ky projekt synon shkëmbimin e informacionit për mundësitë e tregut të punës si për punëkërkuarit ashtu edhe për punëdhënësit. Si dhe shkëmbimin e informacionit mes bizneseve dhe krijimin e mundësisë për promovimin e produkteve të tyre. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e programit të panairit. Përgatitja e materialeve promociionale si postera, banera, ftesa etj. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. Njoftimet në media elektrtronike për zhvillimin e aktivitetit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Njohja dhe prezantimi në rajon e më gjerë të bizneseve prodhuese që operojnë në Bashkinë Shkodër si dhe nxitja e punësimit të studendeve. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Universiteti Shkodër Shkollat e mesme profesionale Zyra Rajonale e Punësimit Shkodër				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Total i (000 lekë)	Nga kjo:			
A.1	Materialeve promociionale dhe instalimi i logjistikës	300	Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e Kapital e
Shuma		300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Total i (000 lekë)	Nga kjo:			
A.1	Materialeve promociionale dhe instalimi i logjistikës	300	Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e Kapital e
Shuma		300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Total i (000 lekë)	Nga kjo:			
A.1	Materialeve promociionale dhe instalimi i logjistikës	300	Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e Kapital e
Shuma		300			300	

<p>f) Periudha e zbatimit</p> <p>Gjatë vitit 2022, 2023,2024</p>	<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit</p> <p>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</p>
---	---

Nr. 7	P04130.O2.A2 Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoaria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Kjo pasuri mund të hulumtohet nga aspekte të ndryshme, sepse paraqet një fushë të gjërë, ku pa dyshim një vend të rëndësishëm zënë produktet agropërpunuese. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë, vërehet prania e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejtë me tregtinë. Por, përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër, me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse do të organizohet panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair do të prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional, ku secila do të ndërtojë në panair standën e saj. Ky manifestim do të jetë i tipit të hapur për pjesëmarrësit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vëndase.</p> <p>Per aktivitetin Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative, procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69 Dt.: 30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile"</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Ky projekt ka për qëllim promovimin e produkteve të sektorit agropërpunuese sipas njësive administrative të Bashkisë Shkodër. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e programit të panairit të produkteve agropërpunuese. Përgatitja e materialeve promociionale si postera , banera , ftesa etj. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje e një numri të gjërë prodhuesish të produkteve vëndase, përfaqësimi i 11 njësive administrative në panair me produktet që i karakterizojnë. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregëtisë Bisnese Prodhuesish Shoqata që operojnë në këtë fushë				Bashkia Shkodër Donatorë		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operat ive	Transfer ime
A.1	Panairi i produkteve agropërpunuese	700			700	
Shuma		700			700	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operat ive	Transfer ime
A.1	Panairi i produkteve agropërpunuese	700			700	
Shuma		700			700	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operat ive	Transfer ime
A.1	Panairi i produkteve agropërpunuese	700			700	
Shuma		700			700	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë vitit 2022, 2023,2024		Drejtoaria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr. 8	P04130.O2.A3 Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Të tilla janë, kostumet e qytetit (të komunitetit musliman, atij katolik dhe ortodoks), të zonave rurale (të Postribës, të Zadrimës, të Bregut të Bunës etj), të Malësive (Shale, Shosh, Pult). Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzorë përmes këngës, vlen për tu theksuar ahengu shkodran, këndimi me lahutë i rapsodive të vjetra kreshnike, këngët e shoqëruara me çifteli, vallëzimi në çift ose në grup. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet natyrore të saj.</p> <p>Në këtë kuadër është parashikuar organizimi i panairit në njësitë administrative. Ato do të prezantohen me pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Ky panair vlerësohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyrore që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit.</p> <p>Këto panire do të jenë të tipit të hapur për pjesëmarrësit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktivitete kulturore e më shumë prodhime vendase. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit (për njësitë administrative).</p> <p>Në vitin 2021 është parashikuar të zhvillohet nga një panair për secilën nga 8 njësitë administrative të Bashkisë Shkodër të cilat nuk janë të mbuluara me aktivitete promovuese nga programe të tjera të Bashkisë. Ne vitin 2020 janë realizuar aktivitete promovuese në të gjitha njësitë administrative, të cilat janë mirëpritur nga banorët e zonës dhe vizitorë të ndryshëm. Gjithashtu, edhe në vitet ne vazhdim do të zhvillohen keto aktivitete për secilën nga njësitë administrative, duke krijuar kështu një traditë të përvitshme në promovimin e territorit të njësisë administrative.</p> <p>Për aktivitetin Panairi i promovimit të vlerave artistike - kulturore dhe i produkteve të territorit, procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.: 69 Dt.: 30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile"</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Ky projekt ka për qëllim promovimin e vlerave tradicionale të trashëgimisë kulturore dhe produkteve vendase të njësive administrative të Bashkisë Shkodër. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Aktiviteti artistik i vlerave kulturore të zonave. Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit; Përgatitja e materialeve promocionale si postera, banera , ftesa etj. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Realizimi i panairit në 8 njësitë administrative, me pjesëmarrjen e një numri të gjerë prodhuesish të produkteve vendase. Përfaqësimi i njësive administrative në panair me vlerat dhe produktet që i karakterizojnë. Promovimi i territorit. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Biznese Prodhuesish Shoqata që operojnë në këtë fushë Banorët e Nj. Administrative				Bashkia Shkodër Donatorë		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transferi me

A.1	Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit	1,440				1,440	
	Shuma	1,440				1,440	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transferi me	Kapital e
A.1	Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit	1,440				1,440	
	Shuma	1,440				1,440	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transferi me	Kapital e
A.1	Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit	1,440				1,440	
	Shuma	1,440				1,440	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë vitit 2022, 2023,2024		Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit					
		Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 9	P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nenit 8, pika 1 dhe 2; dhe nenit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" .</p> <p>Neni 8 Nëpunësit që ushtrojnë funksione të deleguara</p> <p>1. Nëpunësit e sporteve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë nëpunës civilë të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.</p> <p>2. Nëpunësit e sporteve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji, janë punonjës të organizatës përkatëse, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Neni 9 Pagat</p> <p>2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve apo punonjësve të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 8, të këtij ligji, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, nga njësitë e qeverisjes vendore apo subjektet e tjera, me të cilat QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Në zbatim të këtij ligji, Bashkia Shkodër ka lidhur me QKB-në, marrëveshjen e bashkëpunimit nr 6074 date 25.05.2016 ku në nenin 5 pika 1 përcaktohet:</p> <p>"Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së qeverisjes vendore , përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak duke marrë në konsideratë fondin e deleguar nga QKB –ja për këtë qëllim. Këto funksione të deleguara tashmë kryhen nga Bashkia dhe gjithashtu me Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr 6 datë 30.01.2018 " Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucioneve të varësisë". janë përcaktuar disa nivele page në kategorinë e pozicionit ku paguhen nëpunësit e sporteve të shërbimit të QKB-së.</p> <p>Aktualisht janë dy punonjës që ofrojnë shërbimin pranë zyrës së QKB në Bashkinë Shkodër.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurohet një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e pagesave dhe shpenzimeve sipas parashikimeve. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Shërbim më i mirë për qytetarin 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontribute të mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Punonjësit e QKB • Komuniteti i biznesit • Qytetarët • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 				Bashkia e Shkodrës		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime QKB	1,635	1,337	212	86	
Shuma		1,635	1,337	212	86	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime QKB	1,666	1,363	217	86	
Shuma		1,666	1,363	217	86	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime QKB	1,698	1,391	221	86	
Shuma		1,698	1,391	221	86	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë vitit 2022, 2023, 2024		Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				

Nr.10	P04130.O3.A1 Botim i profilit të bizneseve të Bashkisë Shkodër në anglisht	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Hartimi i profileve të bizneseve të Bashkisë Shkodër synon të ofrojë një përmbledhje të historive të suksesit të këtyre bizneseve, duke bërë një historik të shkurtër që nga krijimi i tyre e deri në ditët tona, e gjitha kjo e pasuruar edhe me lloje të produkteve që këto ndërmarrje prodhojnë. Ky botim kësaj here do vijë në gjuhën angleze. U pa e domosdoshme që pas botimit të parë në shqip, të botohej edhe në anglisht duke përfshirë brenda edhe biznese të tjera që do duan të jenë pjesë e këtij katalogu. Ky katalog do të ofrojë një panoramike të sipërmarrjeve lokale dhe produkteve të tyre, duke i dhënë mundësinë cdokujt të njohë më mirë prodhimet apo shërbimet që ato ofrojnë, kapacitetin e prodhimit etj. Ky botim do të jetë i disponueshëm edhe në faqen Web të bashkisë në formë elektronike.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Ky projekt synon promovimin e sipërmarrjeve të suksesshme, të produkteve që ato ofrojnë si dhe njohjen e tyre nga ana e punëkërkuësve. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Përditësimi i bizneseve që kanë qënë pjesë e Katalogut të Bizneseve të Bashkisë Shkodër dhe përfshirja e bizneseve të reja. Takimi me bizneset e përzgjedhura për hartimin e profilit. Përgatitja e struktures së profilit të bizneseve. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Profilet e ndërmarrjeve prodhuese të realizuara. Përgatitja e draftit për botim. Promovimi i publikimit 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontribute të mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër Sipërmarrjet e ndryshme.				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Përgatitja e draftit dhe publikimi i profilit të bizneseve					
Shuma						
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Gjatë vitit 2022, 2023, 2024			Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit			
			Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër			

Nr. 11	P04130.O3.A2. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Bashkia Shkodër ka tashmë një shtrirje territoriale të madhe dhe gjithashtu ka edhe detyrën e shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për të arritur këtë qëllim duhet bërë një klasifikim i zonave zhvillimore sipas pozicioneve përkatëse gjeografike dhe sipas sektorëve të zhvillimit. Një pikë e rëndësishme është seleksionimi i industrive dhe funksioneve ekonomike të zonave zhvillimore, duke zgjedhur industri të lehtë, zhvillim turizmi apo bujqësi që është jo dëmtouese për mjedisin apo duke bashkuar me industri të tjera plotësuese ose që ndajnë karakteristika të përbashkëta dhe mund të funksionojnë së bashku. Promovimi i zhvillimit në zonat ekonomike dhe në fashat e zhvillimit ekonomik të përcaktuara në strategjinë e territoriale të Bashkisë Shkodër të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zona e ish-fushës së aviacionit- zonë e lirë ekonomike • Ish-zonës industriale Shkodër (rikualifikim i Brownfield) • Bypassi në një itinerarë natyror • Aksit Ura e Bahçallëkut -Bërdicë si aks ekonomik • Fashat ekonomike: Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik • Aksit rrugor Shkodër - Ana e Malit - Muriqan • Fashat ekonomike - Aksi Shkodër - Vau i Dejës • Rruga Shirokë- Zogaj • Zona e Qendrës Shkodër • Zona pranë By-Pass Perëndimor • Terminali ujqor • Zona Velipojë-Rrjoll • Etj. <p>Një nga masat e bashkisë për të krijuar mundësinë e zhvillimit të këtyre zonave do të jetë edhe promovimi dhe tërheqja e investitorëve vendas dhe të huaj.</p> <p>Përmes bashkëpunimit me drejtorinë e kontrollit dhe zhvillimit të territorit dhe drejtorinë juridike do të detajohen rregulloret dhe procedurat për zhvillimin e këtyre zonave. Faza tjetër do të jetë përgatitja dhe publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore, duke iu referuar rregulloreve dhe procedurave të përcaktuara.</p>						
ii. Synimi I projektit						
Zhvillimi i zonave ekonomike përmes tërheqjes së investimeve vendase e të huaja						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Takime konsultative me aktorët e interesuar. 2. Përgatitja e dokumenteve teknike për funksionimin e zonave zhvillimore. 3. Përgatitja e draftit, botimi dhe publikimi i materialit promocional për zonat zhvillimore 						
b) Rezultatet që prisni						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Universiteti i Shkodër Dhoma e Tregtisë Bizneset Komuniteti				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Botim dhe publikimi i materialit promocional për zonat zhvillimore	200			200	
Shuma		200			200	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ribotim i materialit promociional për zonat zhvillimore	200			200		
	Shuma	200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Botim dhe publikimi i materialit promociional për zonat zhvillimore	200			200		
	Shuma	200			200		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr.12	P04130.O4.A1 Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë është rinovuar marrëveshja për vitin 2018 dhe në kuadër të saj, Shoqata BID ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitete kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Ka ofruar konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit në këtë zonë. Në Rr. “Kolë Idromeno” si rezultat i bashkëpunimit me Shoqatën BID Shkodër, nga një pjesë e mirë e bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë është aplikuar koncepti “Dehors” për zënien e hapësirës publike, i miratuar në “Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike”. Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Në këtë kuadër vazhdimi i bashkëpunimit me shoqatën BID Shkodra në shërbim të përmirësimit të zonave të biznesit do të realizohet në zbatim të ligjit Nr. 63/2020 Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID), Neni 23 Vazhdimësia e shoqatave ekzistuese BID.</p> <p>Të lirohet hapësira në pedonalen Kolë Idromeno nga ndërtime, parkingjet, dhe kioskat. Hapësira publike të trajtohet me rigorozitet sipas vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit dhe jepet në përdorim vetëm për ato subjekte që zbatojnë kriteret sipas këtij plani. Çdo muaj, Kryetari i Bashkisë të raportojë me shkrim tek Këshilli Bashkiak për hapat e ndërmarra.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Qëllimi kryesor i bashkëpunimit është që të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe më tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t’iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojnë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt por edhe atyre potencial.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të të ardhurave nga tarifat, që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr. 13, datë 12.03.2012.						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Forcimi dhe zhvillimi i bizneseve egzistuese, krijimi i bizneseve të reja si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, që ndodhen përgjatë rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. 						
c) Aktorët e mundshëm					d) Kontributet e mundshme në projekt	
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër AADF BID Shkodër 					Bashkia Shkodër	
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operati ve	Trans ferime
A. 1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	1,600				1,600
Shuma		1,600				1,600
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operati ve	Trans ferime
A. 1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	1,600				1,600
Shuma		1,600				1,600
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024			Nga kjo:			

		Totali (000 lekë)	Paga	Siguri me	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblihen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar.	1,600				1,600	
Shuma		1,600				1,600	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr.13	P04130.O4.A2 Mbështetja e iniciativave të reja të Zonave Tregtare.	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik					
a) Përshkrim i shkurtër i projektit							
i. Situata							
<p>Një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër është zhvillimi i qendrueshëm ekonomik dhe përmirësimi i klimës së biznesit në territorin e saj. Për këtë qëllim Bashkia do të vazhdojë të mbështesë iniciativa të reja për zhvillimin e biznesit, në fusha që lidhen me vizionin e zhvillimit të saj. Iniciativa të tilla kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e zonave të reja tregtare si dhe nxitjen e kulturës së sipërmarrjes duke ju përgjigjur zhvillimeve të reja në kohë dhe në mënyrë krijuese. Konkretizimi i ndërhyrjeve në zonat karakteristike të Shkodrës të cilat kanë një potencial të lartë për kthimin e tyre në atraksione turistike dhe integrimi i tyre me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Trashëgimia dhe kultura identifikohen si elemente të forta territoriale dhe Shkodra është një ndër destinacionet më të rëndësishme në Shqipëri. Prandaj është me shumë interes krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për terheqjen e investimeve në zonat e përmirësimit të biznesit dhe organizimin e veprimtarive kulturore - artistike në mënyrë që të rrisim numrin e vizitorëve dhe kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Nisma të tilla nuk kanë munguar edhe më përpara, mjafton të përmendim projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno" por është e nevojshme shtrirja e tyre edhe në zona të tjera historike të Shkodrës, ku pa dyshim Shkodrës nuk i mungojnë. Të tilla mbështetje do të ndikojnë në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë, gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të lira të pune.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e sa më shumë bizneseve për të konsoliduar dhe rritur aktivitetin e tyre ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i zonave gjeografike të caktuara për përmirësimin e bizneseve. Organizimi i tryezave të përbashkëta me bizneset. Themelimi i Zonës së re tregtare. Mbështetja financiare nëpërmjet transferimit të të ardhurave nga tarifat, që mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës. 							
b) Rezultatet që prisni							
Krijimi i Zonës së re të Përmirësimit të Biznesit përgjatë një prej rrugëve karakteristike të shkodres. Rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, të bizneseve që ndodhen përgjatë rrugës së perzgjedhur.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare	1,300			1,300		
Shuma		1,300			1,300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare	1,300			1,300		
Shuma		1,300			1,300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali	Nga kjo:				

		(000 lekë)	Paga	Siguri me	Operati ve	Transferim e	kapitale
A. 1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare	1,300			1,300		
Shuma		1,300			1,300		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 14	P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik							
a) Përshkrim i shkurtër i projektit									
i. Situata									
<p>Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumentacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme.</p> <p>Programet mbështetëse dhe instrumentat financiarë qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforsimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Stafi i Bashkisë Shkodër, është angazhuar në dhënien e informacionit teknik, në mbështetjen për shkrimin e projekteve, në orientimin, dhe në bashkëpunimin për gjetjen e organizatave që japin asistencë e këshillim teknik, kur kjo ka qenë e mundur.</p>									
ii. Synimi i projektit									
<ul style="list-style-type: none"> Shtimi i bizneseve që aplikojnë në mënyrë të suksesshme për të përfituar nga programet dhe skemat e ndryshme financiare shtetërore. 									
iii. Aktivitetet kryesore të projektit									
<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim; Azhornimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar subjektet e ndryshme; Asistenca për plotësimin e dokumentacionit për aplikim. 									
b) Rezultatet që prisni									
<ul style="list-style-type: none"> Rritja e numrit të bizneseve që përfitojnë nga programet dhe skemat e ndryshme financiare. 									
c) Aktorët e mundshëm					d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë AIDA					Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura									
Shpenzimet për çdo aktivitet				Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare								
Shuma									
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2022, 2023,2024				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					